




Programi i Partneritetit Evropian me Komunat

Raporti i tetë tremujor

1 janar – 31 mars, 2013



Programme Funded by EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Implementing Partner



Programme Funded by EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun Svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Implementing Partner



European Partnership with Municipalities Programme

Përmbledhje

Në fund të tremujorit të parë të vitit 2013, EU PROGRES ka kontraktuar 201 projekte: 107 ose 53% kanë përfunduar, që përbën një rritje prej 8% në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese; 42 (21%) u implementuan me kohë; 41 (20%) u vonuan me rrezik të ulët; një projekt është kritik; asnjë projekt nuk është ndërprerë gjatë këtij tremujori. Numri i përgjithshëm i projekteve të ndërprera deri më tani është dhjetë.

Përprojekjet e EU PROGRES-it për të lehtësuar investimet dhe për të gjeneruar punësim kanë qenë të frytshme: është vlerësuar se prodhuesi i këpucëve italiane Geox do të investojë rreth 16 milion EURO dhe do të punësojë 1,250 persona brenda një deri tre vjetëve, në fabrikën e re e cila do të ndërtohet në Vranjë. Përkrahja e EU PROGRES-it në hartimin e planit të rregullimit detal (DRP) për Zonën Industriale të Vranjës është instrumentale për stimulimin e këtij projekti dhe investimeve të tjera pasi që janë krijuar kushtet për të dhënë lejen e lokacionit. Zhvillime pozitive janë regjistruar gjithashtu edhe në Zonën e Gjelbër të Leskocit, që është një nga projektet më të rëndësishme të EU PROGRES-it, ku një kompani Greke ka shprehur interesimin të investojë 75 milion euro në prodhimin e algave dhe Qyteti është duke konsideruar që të shfrytëzojë një pjesë të Zonës së Gjelbër për fabrikën e re. Kjo mund të jetë një zhvillim shumë pozitiv por gjithashtu mund të ndryshojë konceptin inicial për Zonën e Gjelbër.

Ky tremujor gjithashtu ka demonstruar rëndësinë e planifikimit dhe dokumentacionit teknik. Sjenica për shembull duke përdorur dokumentacionin teknik ka zhvilluar përmes EU PROGRES-it dhe programit paraprak PRO dhe duke vazhduar punën në ndërrimin e gypave të ujit që ka filluar me përkrahjen e EU PROGRES-it, ka siguruar rreth 19,5 milion dinar për projektet e reja nga Qeveria e Serbisë. Në Bujanoc, iu është mundësuar komunës që të punojnë në zhvillimin e projektit kryesor për ndërtimin e bunareve të ujit, që do të përmirësojë furnizimin me ujë për qytetin dhe vendbanimet e tij.

Puna e programit në menaxhimin e mirë ka bërë disa arritje të rëndësishme. Buxheti i participues që u implementua në 12 komuna ka treguar impakt inicial: buxhetet lokale për vitin 2013 në të gjitha 12 komunat participuese reflektojnë prioritete të specifikuar nga rreth 5,000 qytetar të cilët morën pjesë në forumet buxhetore ose kanë votuar për preferencat e tyre për të alokuar fondet lokale. Për shembull, në Vranjë, prioriteti më i madh për qytetarët ishte punësimi i të rinjëve dhe Qyteti ka alokuar 38 milion dinar për këtë arsye, për herë të parë. Prioritet për qytetarët e Leskocit ishte hapja e vendeve të punës dhe Qyteti ndau mjete për punësimin e 54 profesionistëve të rinj me notën mesatare mbi 9.00 përderisa 70,000 Euro u ndanë për subvencione punësimi. Projektet e Fondit për Shoqatat Qytetare (CIF) kanë vazhduar të përmirësojnë jetesën në nivelin lokal dhe prapë ka dëshmuar që është një shembull solid për ndërtimin e kapaciteteve: krahasuar me CIF-1, ku realizimi i gjysmës së projekteve ishte me vonesë që rezultoi në vazhdimin e kontratave, pas pesë muaj implementimi të projekteve nga CIF-2, vetëm tre projekte, nga 26 duhet të vazhdojnë kontratën. Gati 570 qytetar kanë marrë përkrahje përmes Zyrave për Shërbime Juridike Falas (CAS).

Nova Varosh ka bërë një hap të madh në krijimin e kornizës institucionale për përmirësimin e kualitetit të jetesës për meshujt dhe femrat në nivelin lokal, përmes përkrahjes së EU PROGRES-it. Në Mars, Këshilli Komunal ka votuar për themelimin e Këshillit të Barazisë Gjinore, ka aprovuar Planin e Akcionit Lokal për Barazi Gjinore dhe Kartën Evropiane për Barazinë e Meshkujve dhe Femrave në Jetën Lokale. Priboji gjithashtu ka aprovuar Kartën Evropiane. EU PROGRES ka vazhduar përkrahjen e komunave për të përgatitur planet lokale të akcionit (LAP) për përmirësimin e pozitës së femrave. Sjenica, Rashka dhe Zhitoragja kanë aprovuar planet, përderisa Planet e Akcioneve Lokale të Ivanjicës, Prijepoles, Pribojit dhe Tutinit janë futur në procedurë.

Në 14 komuna ku Programi është duke përkrahur lidhshmërinë e projekteve të vogla të infrastrukturës me praktikën e menaxhimit të mirë (GG) ekzistojnë rreth 30 rregullore të ndryshme të reja ose të reviduara të aprovuara nga kuvendet komunale, përderisa 14 rregullore shtesë janë në fazën përfundimtare, që presin të hyjnë në procedurë të kuvendeve komunale.

Theksi i Komponentës 2 për tërë tremujorin mund të themi se është përkrahja e suksesshme shërbimeve tatimore të administratave lokale (ATL). Të ardhurat në 11 komuna që marrin pjesë në projektin administratës tatimore kanë rritur të ardhurat për 20% pasi që numri i taksapaguesve të regjistruar është rritur për 17,000, që është dyfishuar nga numri që është planifikuar në fillim të Programit EUPROGRES. Sipas raporteve finale dhe bilanceve të mbyllura të ATL-ve rritja në tatimin e pronës së regjistruar gjithsej është rreth 700,000 Euro ose mesatarisht rreth 37.3%. Rritja në tatimin e pronës e grumbulluar (e paguar) është rreth 210,000 Euro ose mesatarisht rreth 24.6%.

Puna në projektet e infrastrukturës ka patur progres. Prokurimet Publike për ndërtimin e përpunuesve të ujërave të zeza (WWTP) ishin të suksesshme në Tërgovishtë dhe Crna Trava. Përpunuesit e ujit duhet të pastrojnë ujërat e zeza për rreth 3,750 banor. Këto dhe projektet tjera lidhur me zhvillimin e dokumentacionit teknik për tri qendra të reciklimit, deponia regjionale Meteris, studimet për përpunuesit e ujërave të zeza në Kopaonik, si dhe disa projekte lokale të infrastrukturës që përfshijnë lëndët djegëse me biomasë dhe zvogëlojnë lëshimin e CO₂, do të kontribuojnë në pastrimin e ajrit dhe ujit në regjion. Projektet e kompletuara të infrastrukturës lokale vazhdojnë të japin rezultate: Klinika Dentale në Nova Varosh ka regjistruar 1,100 ekzaminime të fëmijëve shkollor në tremujorin e parë të vitit 2013 që përbën 60% të të gjitha ekzaminimeve të bëra në vitin 2011; për shkak të instalimit të sistemit të ngrohjes që përdor lëndë djegëse të bio masës në Prijepolje dhe në shkollën e mesme në Novi Pazar nuk ka pasur shkurtime të orëve duke iu falënderuar bojlerëve të ri dhe temperatura mesatare nëpër klasë ka arritur 24 shkallë, krahasur me 15 gradë sa ka qenë në stinën e mëparshme. Në Vranjë ndërmarrja komunale publike (NKP) gjatë rregullimit të furnizimit me ujë në vendbanimin e Romëve të quajtur Qoshka ka instaluar pompa të ujit dhe rregullatorë të presionit të kapacitetit të lartë duke i krijuar parakushtet teknike për rikonektimin e dy vijave sekondare të rrugës ekzistuese në afërsi të vendbanimit të Romëve. Si rezultat, presioni i ujit në ato gypa është shumë më i mirë dhe furnizimi i rregullt me ujë për 45 familje është siguruar.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2013, mbi 270 raporte të mediave u publikuan në tërë vendin, pesë herë më shumë se sa ishte e planifikuar. Audienca e jashtme e vlerëson komunikimin e Programit si “të qartë, me informata të dobishme, me mungesë të gjuhës birokratike”. Websajtin e Programit e kanë vizituar 5,798 vizitor gjatë këtij tremujori, krahasuar me 2,500 vizitor sa ishte e planifikuar për çdo tremujor, prandaj plani është dyfishuar. Aq më tepër, kjo përbën një rritje prej 16% në krahasim me periudhën e njëjtë vitin e kaluar.

Programi ka trajtuar çështje të suksesshme të projekteve kritike: nga gjashtë në janar të vitit 2013, ky tremujor ka përfunduar me një projekt (të ri) kritik. Jostabilitetet politike në nivelin lokal kanë vazhduar dhe variojnë nga ndryshimet e koalicioneve deri tek arrestimet e kryetarëve të mëparshëm. Kjo ka pasur ndikim në Program, pasi që disa nga ndryshimet kanë ngadalësuar implementimin e projekteve. Megjithkëtë, Programi ia arriti të (ri) themelonte bashkëpunimin shumë shpejtë. Ekzistojnë edhe dy rreziqe që u paraqitën gjatë kësaj periudhe, që kërkojnë trajtim nga EU PROGRES-i dhe Këshilli Drejtues (KD) sa më shpejtë. Së pari, EU PROGRES-i duhet të shpenzojë fondet e mebtura dhe Programi ka përgatitur kërkesat. Së dyti, ka paqartësi me disa projekte që ishin aprovuar më herët. Këto paqartësi e parandalojnë Programin që të nënshkruajë kontratat e granteve dhe të fillojë implementimin, duke lënë një pjesë solide të mjeteve të “bllokua”. Projekti për ndërtimin e ndërtesës së fakultetit në Bujanoc është një shembull për këtë: EU PROGRES ka rezervuar rreth 250,000 Euro për këtë projekt por për shkak të paqartësive lidhur me pronësinë e tokës, mungesës së mjeteve për tërë projektin si dhe komplikimeve të tjera, në këtë



Programme Funded by EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun Svizra
Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Implementing Partner



European Partnership with Municipalities Programme

fazë, paraqesin rrezik shumë të madh për të lejuar grantin. Prandaj, është esenciale që Këshilli Drejtues të marrë vendim lidhur me disa projekte të pazgjidhura si dhe të marrë në konsiderim kërkesat e bëra, në gjysmën e parë të prillit. Përndryshe, Programi mund të mos ketë mundësi që të kompletojë projektet me kohë, qoftë edhe nëse vendimet janë pozitive.